


TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE PËRGJATË DHËNIES SË LEJEVE DHE LICENCAVE



Përmbajtja

HYRJE **4**

METODOLOGJIA **5**

BAZA LIGJORE **6**

STRUKTURA
ORGANIZATIVE **8**

ÇKA NËNKUPTOJMË ME
LEJE MJEDISORE, LEJE
KOMUNALE, LEJE TË
INTEGRUAR DHE
LEJE UJORE? **11**

SFIDAT EKZISTUESE
PËRGJATË DHËNIES SË
LEJEVE NË KOSOVË **19**

PËRFUNDIME **28**

REKOMANDIME **29**

HYRJE

Qëndrueshmëria hapësinore lidhet me aftësinë afatgjate të qyteteve dhe vendbanimeve për të planifikuar me sukses rritjen e urbanizimit të tyre, duke ruajtur rritjen ekonomike, duke krijuar mjedisë të qëndrueshme, duke rritur zhvillimin social dhe duke kontribuar në rritje të transparencës. [1]

“Qytete dhe komunitete të qëndrueshme” – Objektivi i 11 për Zhvillim të Qëndrueshëm, objektivi i cili marrë parasysh (pa)planifikimin urban në Kosovë lë shumë për të dëshiruar. Sfidat rrënjësore me menaxhimin urban, konkretisht me lëshimin e lejeve urbanistike – mjedisore, vazhdojnë të jenë prezente pavarësisht nënshkrimit të Agjendave dhe Marrëveshjeve të cilat tërthorazi synojnë eliminimin e tyre. Të sigurohet mirëqenia sociale krahas përpjekeve të vazhdueshme me qëllim të krijimit të një mjedisi të qëndrueshëm, padyshim që paraqet një sfidë në vetvete, sidomos për një vend në tranzicion si Kosova.

Përderisa anë e mbanë globit flitet për qëndrueshmëri, paralelisht, pa patur nevojë të realizohet ndonjë analizë e thellë, mjafton të vështrohen ndërtimet e objekteve shumëbanesore të cilat pa përmbushur kriterin prej 9m 2 sipërfaqe gjelbëruese për kokë banori [2] vazhdojnë të ndërtohen. Shtrirja e paplanifikuar urbane si rezultat i lëvizjes së pa kontrolluar të popullsisë, ka rezultuar në rritje të numrit të vendbanimeve, operuesve dhe ndërtesave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme në të gjithë Kosovën. “Raporti për gjendjen e mjedisit në Kosovë 2021” publikuar nga AMMK-ja, vë në pah se edhe pse janë hartuar dhe aprovuar strategji dhe plane të veprimit për të gjithë sektorët mjedisor si në nivel qendror dhe në atë lokal [3], komunikimi jolinear ndërmjet tyre si dhe niveli zbatues i dokumenteve strategjike nga to, mbetet i pjesshëm dhe i pamjaftueshëm për të siguruar një planifikim të mirëfilltë. Periudha e stërzgatur e sjelljes së ndryshimeve rrënjësore në institucionet publike për arsye të ndryshme, si dhe niveli i ulët i llogaridhënies dhe transparencës si parime qëndrore për një qeverisje të mirë, kanë nxitur një nevojë të domosdoshme për monitorim dhe themelim të një bashkëpunimi të mirëfilltë me organet qeveritare përgjegjëse.

Rrjedhimisht, ky raport tematik do të përqëndrohet kryesisht në identifikimin e barrierave të hasura gjatë dhënies së lejeve dhe licencave duke i kushtuar vëmendje të veçantë nivelit të transparencës dhe llogaridhënies të demonstruar nga institucionet. Përgjatë shqyrtimit të këtyre dy indikatorëve, ne synojmë të identifikojmë fushat ku mund të ofrohen rekomandime dhe përmirësime. Gjithashtu do të vëmë në pah praktikën më të mira që mund të shërbejnë si modele për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të përgjithshëm të dhënies së lejeve dhe licencave, duke kontribuar kështu në zhvillimin e strategjive dhe politikave që nxisin një sistem më transparent më të përgjegjshëm dhe më efikas për dhënie e tyre.

[1] E ardhmja e Planifikimit Territorial në Kosovë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nëpartneritet me UN-Habitat Kosova, e qaashme në:

https://unhabitat-kosovo.org/ep-content/uploads/2021/09/MMPHIUN-Habitat_Kosovo-2021-Raporti_i_Simpoziумit-E_Ardhmja_e_Planifikimit_Territorial_në_Kosovë.ALBS_.pdf

[2] World Health Organization: Health Indicators of Sustainable Cities in the Context of the Rio+20 UN Conference on Sustainable Development, e qaashme në: https://cdn.who.int/media/docs/default-source/environment-climate-change-and-health/sustainable-development-indicator-cities.pdf?sfvrsn=c005156b_2

[3] MMPHI/AMMK, Raporti vjetor për gjendjen e mjedisit 2020.

METODOLOGJIA



Ky raport tematik paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të kryer përmes një metodologjie kërkimore duke kombinuar ato cilësore dhe sasiore. Procesi i kërkimit përfshin shqyrtimin e një game të gjerë dokumentesh relevante dhe mbledhjen e të dhënave dhe informacionit nga burime të ndryshme përfshirë raportet e publikuara nga institucionet e targetuara si dhe shoqëri të ndryshme. Integrimi i metodave cilësore dhe sasiore të përdorura, mundësoi një eksplorim më të plotë të temës së kërkimit, duke rritur vlefshmërinë dhe besueshmërinë e gjetjeve të paraqitura në këtë raport.

Për ta bërë këtë raport sa më gjithëpërfshirës dhe relevant, janë organizuar takime si dhe forume avokuese me përfaqësues nga MMPHI si dhe zyrtarë të Drejtorive të Urbanizmit dhe të Mbrojtjes së Mjedisit në nivel komunal. Përveç kësaj, janë intervistuar akterë institucional të nivelit qendror, të nivelit komunal, përfaqësues të bizneseve të ndryshme, investitorë potencial si dhe konsulentë e ekologë. Këto intervistime na mundësuan të mbledhim njohuri, të mësojmë detaje që legjislacioni shpesh herë nuk i parasheh dhe të fitojmë ekspertizë në këtë fushë. Për më tepër, për t'u pajisur me informata të dorës së parë, monitoruesit tanë në mënyrë aktive morën pjesë në procedurat për dhënie e lejeve dhe licencave duke rritur kështu saktësinë dhe besueshmërinë e gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit.

BAZA LIGJORE

Përgjatë hulumtimit dhe analizës së kornizës legjislative, janë identifikuar 47 leje të cilat administrohen nga MMPHI. Këto leje shtjellohen në Udhëzime Administrative, akte nënligjore të cilat burojnë nga një mori ligjesh. Kompleksiteti i paarsyeshëm i tërë kornizës ligjore ka dërguar në hulumtime të pavarura jashtë kufijëve tradicional, duke ngritur dyshime mbi efikasitetin dhe transparencën e këtij sektori. Me rritjen e boshllëqeve të kapaciteteve institucionale në kombinim me mospërputhjet në kornizat e ndryshme ligjore, planifikimi aktual i territoreve komunale, menaxhimi i mjedisit (veçanërisht të zonave urbane) është duke u vështirësuar gjithnjë e më shumë. Sipas raportit të Bankës Botërore, gjithsejtë 31 leje mund të thjeshtëshohen, bashkohen apo edhe të eliminohen. Shtjelluar më poshtë, janë tri ligjet kryesore prej të cilave rrjedhin Udhëzimet Administrative, tregues të procedurave për marrje të Lejeve Mjedisore, Lejeve Mjedisore Komunale si dhe Lejeve Ujore, procese të shtjelluara në një kapitull të veçantë.



Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

Objektivi i këtij ligji është të krijojë një mjedis të favorshëm që promovon mirëqenien e popullit të Kosovës. Ai gjithashtu synon të përcaktojë një kornizë ligjore që lehtëson miratimin e standardeve në harmonizim me ato të Bashkimit Evropian, duke siguruar kështu një mjedis të shëndetshëm për qytetarët e Kosovës



Ligji për Ujërat e Kosovës

Me këtë ligj rregullohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ujërat: ilqenet, akumulimet, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësorë, tokat e lagëta, truallin buzë brigjeve të lumenjve, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e tyre, përdorimin dhe shpërndarjen e ujërave, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujërave.



Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis të projekteve publike apo private, të përcaktoj rregullat dhe procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve në mjedis, për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative.[5]

Qëllimi kryesor i këtij ligji është që të sigurojë se krijimi i një mjedisi të tillë është arritur në një mënyrë të përballueshme dhe konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Ky ligj identifikon autoritetet publike që do të bëjnë implementimin e një apo më shumë dispozitave të këtij ligji, krijimin e autoriteteve specifike dhe detyrimet e secilit autoritet publik që buron nga ky ligj. Gjithashtu në këtë ligj, janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e personave apo ndërmarrjeve të prekura nga aktivitetet e autoriteteve të tilla publike apo me persona të interesuar për promovimin e mjedisit të shëndetshëm në Kosovë. [4]

Ligji në fjalë, gëzon kompetencat për zbatimin e të gjitha përkufizimeve, shtjellon të gjitha rolet e organeve të larta qeveritare, autoriteteve publike, përshkruan dokumentet si dhe masat kryesore për mbrojtjen e mjedisit, detyrimet e ndryshme përfshirë masat rehabilituese, procedurat e VNM-së, Pëlqimeve dhe Lejeve Mjedisore, të cilat detajisht janë të përshkruara në Udhëzimin Administrati (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Gjithashtu ky ligj përfshin edhe mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujërave duke përfshirë përmbytjet, vërshimet, thatësitë, erozionin, objektet dhe infrastrukturën ujore, financimin e ujërave, si dhe kushtet, mënyrat dhe veprimet me të cilat mund të shfrytëzohen ose shkarkohen ujërat. Akti nënligjor i përcaktuar sipas nenit 17 të këtij ligji i cili në mënyrë specifike është rregullator i së drejtës ujore, respektivisht zbatimit të Ligjit Ujërave dhe Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore përmes akteve ujore në cilësinë e instrumenteve administrative, është Udhëzimi Administrativ për Procedurat për Leje Ujore.

Ky dokument përcakton detajisht mënyrat dhe procesin e zbatimit të Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore, në kuadër të procesit me administrimin e resurseve ujore. Udhëzimi përcakton mënyrën dhe procesin e lëshimit të akteve ujore (Kushtet Ujore, Pëlqimin Ujor, Lejen Ujore dhe Urdhëresën Ujore), përmes së cilave palëve të interesuara u garantohet e drejta e shfrytëzimit, rregullimit dhe shkarkimit të ujërave.

Udhëzuesit administrativ të cilët burojnë nga ky ligj kanë për synim zbutjen e efekteve të mundshme mjedisore nga impiantet, ndërtimet apo aktivitetet e propozuara, përpara realizimit të tyre:

Udhëzim Administrativ për Licencim të Hartuesve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;

Udhëzim Administrativ për Informim, Pjesëmarrje të Publikut dhe Palëve të Interesuara në Procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;

Udhëzim Administrativ për Përcaktimin e Vlerës së Tarifës për Shërbimet lidhur me procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;

Në mënyrë tërthorazi, aktet ligjore të lartpërmendura nxisin transparencën, pjesëmarrjen publike dhe llogaridhënien, duke siguruar që shqetësimet apo interesat e komuniteteve të cilat preken nga investimet e planifikuara të merren parasysh.

Në fund të fundit, këto rregullore shërbejnë si një mjet jetik për nxitjen e zhvillimit të përgjegjshëm, minimizimin e ndikimeve negative në mjedis dhe nxitjen e një bashkëjetese harmonike midis aktiviteteve njerëzore dhe botës natyrore.

[4] Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Mjedisit, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716>

[5] Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, e qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2708>


STRUKTURA ORGANIZATIVE

MINISTRIA E MJEDISIT,
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
DHE INFRASTRUKTURËS

AGJENCIA KADASTRALE
E KOSOVËS

Agjencia Kadastrale e Kosovës është autoriteti përgjegjës për mirëmbajtjen e bazës së të dhënave kadastrale, për mirëmbajtjen e regjistrave pronësorë, për hartografi dhe GIS, për sistemin e unifikuar të adresave, për infrastrukturën kombëtare të informacioneve hapësinore dhe për administrimin e Infrastrukturës së Teknologjisë së Informacioneve (IT).

Si institucion i nivelit qendror, AKK ka kompetenca për nxjerrjen e udhëzuesve dhe kornizave të punës lidhur me të gjitha veprimtaritë kadastrale. AKK është përgjegjëse për trajnimin dhe certifikimin e zyrtarëve në Zyrat Kadastrale Komunale për operim në Sistemin e Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë dhe për trajnimin, çertifikimin dhe licencimin e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete për ofrimin e shërbimeve kadastrale.[6]

An orange semi-circle representing a sun is positioned behind the title. Three white, stylized clouds are scattered in the light blue sky above the sun.

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) është organi qeveritar kompetent për dhënie të Lejeve Mjedisore dhe Lejeve Ujore. Ky organ angazhohet që përmes monitorimit të integruar të mjedisit, sistemit efikas të informimit mjedisor dhe raportimit të vazhdueshëm për gjendjen e mjedisit, të ruajë kualitetin e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit, të promovojë shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore me qëllim që të sigurojë një mjedis të shëndetshëm për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme në harmoni me progresin e zhvillimeve ekonomike dhe sociale. [7] Ky është edhe misioni i AMMK-së, vizioni i së cilës është monitorimi, informimi dhe raportimi efikas mjedisor.



[7] Misioni i Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, e qasshme në: <https://ammk-rks.net/per-ne>

VEPRIMTARIA E AMMK – SË:




- Të siguroj informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
- Të zhvilloj dhe koordinoj sistemin unik të informimit për mbrojtjen e mjedisit lidhur me sistemin e përcjelljes së gjendjes së mjedisit në Kosovë si dhe të mbledh të dhënat për mjedisin;
- T'i vendosë dhe ti mbaj qendrat referente me bazat e të dhënave për përcjelljen e mjedisit (të dhënat socio-ekonomike, presionet në mjedis, gjendjen dhe kualitetin e mjedisit);
- Të zhvillojë procedurat për përpunimin e të dhënave të grumbulluara për mjedisin dhe vlerësimin e tyre (modelimin, prezantimin dhe paraqitjen vizuale);
- Të kryej punët profesionale gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës së përcjelljes të gjendjes së mjedisit;
- Të avancoj dhe krahasoj cilësinë e të dhënave për mjedisin;
- Të hartoj raporte për gjendjen e përgjithshme të mjedisit në Kosovë, synimeve si dhe të raportojë për sektorët kryesor (ajrin, tokën, ujin, llojllojshmërinë biologjike, ndryshimet klimatologjike);
- Të hartojë raporte për çështjet e caktuar për mbrojtjen e mjedisit siç janë rajonet me radioaktivitet të shtuar, cilësia e mjedisit, shëndetit dhe të ngjajshme;
- Kryen punë këshillëdhënëse për përcaktimin, mbajtjen dhe përcjelljen e projekteve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
- Të ndihmojë organet e administratës në zhvillimin e formave të reja të politikës për mbrojtjen e mjedisit dhe përcjelljen e zbatimit të planeve dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit;
- Të bashkëpunojë me Agjencinë Evropiane të Mjedisit – AEM e cila është në përbërje të Rrjetit Evropian për Informim dhe Vëzhgim – RREIV;
- Të bashkëpunojë me institucionet dhe organizmat tjerë ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit;
- Të siguroj qasjen në të gjitha informacionet për mjedisin e Kosovës sipas standardeve;
- Shfrytëzimi dhe këmbimi ndërshtetëror i të dhënave për mjedis do të rregulluara me ligj;
- AMMK kryen edhe punë të tjera të përcaktuara në aktin për themelimin që shërbejnë për realizimin e veprimtarisë së AMMK. [8]



ÇKA NËNKUPTOJMË ME LEJE MJEDISORE, LEJE KOMUNALE, LEJE TË INTEGRUAR DHE LEJE UJORE?

Leja Mjedisore nënkupton dokumentin zyrtar të lëshuar me shkrim nga ministria me të cilën, i lejohe operatorit zhvillimi i aktiviteteve në pajtim me kushtet e përcaktuara.[9] Të gjitha veprimtaritë, të cilat kanë pëlqim mjedisor janë të obliguara të pajisen me leje mjedisore duke përjashtuar veprimtaritë që janë subjekt i lejes mjedisore të integruar,[10] respektivisht, ndërtimet të cilat supozohen të kenë ndikim më të madh në mjedis.



Leja Ujore paraqet një të drejtë të dhënë me shkrim nga institucionet e përcaktuara në Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës për të përdorur apo shkarkuar një sasi uji për një qëllim dhe kohë të caktuar[11] p.sh. hidrocentralet të cilat kanë për qëllim gjenerimin e energjisë elektrike, duhet të pajisen me Leje Ujore para se të fillojnë me gjenerim të energjisë.

[9] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Udhëzim Administrativ Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, i qasshëm në: <https://gzkrks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=59421>

[10] Ibid.

[11] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës, i qasshëm në: <https://gzkrks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>



Leja Mjedisore e Integruar nënkupton dokumentin zyrtar të lëshuar me shkrim nga ministria që lejon funksionimin e tërë apo të një pjese të impiantit i cili përmban kushtet e nevojshme për të garantuar se impianti është në përputhje me kërkesat e parashtruara në Ligjin Nr. 03/L-043 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes dhe arrin një standard të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.[12] Rast konkret: Termocentralet në Obiliq janë të pajisura me Leje Mjedisore të Integruar pavarësisht ndikimit të dëmshëm të tyre në mjedis.

Leja Mjedisore Komunale sipas Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, është dokument me shkrim që e lëshon komuna, për veprimtari që kanë ndikim në mjedis në nivel komunal, sipas ligjit të lartëpërmendur. [13] Kjo Leje, jipet gjithnjë në përkim me Planin Zhvillimor Komunal, përkatësisht, me planin urbanistik në vendndodhjen ku mendohet të realizohet ndërtimi.



[12] Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, i qasshëm në: <https://gzkrks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71734>

[13] Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Mjedisit, e qasshme në: <https://gzkrks.gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2716>


KU QËNDRON DALLIMI NDËRMJET LEJEVE MJEDISORE, LEJEVE MJEDISORE TË INTEGRUAR DHE LEJEVE MJEDISORE KOMUNALE?

Ndryshe nga Leja Mjedisore, Leja Mjedisore e Integruar (LMI) nevojitet vetëm në rastet kur kemi të bëjmë me funksionimin e impianteve të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në mjedis si p.sh. impiantet të cilat gjenerojnë energji elektrike. Mund të cekim se LMI, duhet të sigurohet për projektet që kanë tendencë të kenë impakt më të madh në ekosistem. Njëjtë si Leja Mjedisore, Leja Mjedisore e Integruar dhe Leja Ujore lëshohen nga MMPHI, ndërkaq Leja Mjedisore Komunale, ashtu sic tregon edhe emërtimi i saj, lëshohet nga komuna përkatëse ku planifikohet të finalizohet investimi.

LMK duhet të përkojë me Planin Zhvillimor Komunal, plan i miratuar paraprakisht nga ministria në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës.



**CILAT HAPA DUHET NDJEKUR PËR
T'U PAJISUR ME LEJE MJEDISORE,
LEJE UJORE,
LICENCË SHFRYTËZIMI?**




RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)

Një investim i çfarëdo lloji natyre që dëshiron të implementohet në Republikën e Kosovës duhet patjetër t'i nënshtrohet kritereve për sigurim të raportit të VNM-së. Ky raport identifikon dhe shtjellon impaktin negativ që investimi i planifikuar mund të ketë në mjedis aty edhe ku do të realizohet. Bazuar në gjetjet e raportit, hartuesi i tij, qoftë ai person juridik apo fizik, shtjellon masat të cilat do të ndërmirren me qëllim të uljes së impaktit negativ dhe rehabilitimit të tokës pas finalizimit të investimit.

VNM-ja paraqet pothuajse dokumentin më me peshë për aplikim për leje, qoftë investim privat apo publik. Përmbajtja e raportit që përmban informacione të detuajara për projektin, përfshirë një përmbledhje jo-teknike, ndikimin negativ që mund të ketë në mjedis, skenarin bazë, alternativat e propozuara si dhe masat për të zbutur efektet e rëndësishme negative duke lehtësuar kështu punën e monitoruesve, inspektorëve institucional, auditorëve apo donatorëve të mundshëm.

VNM-ja merret pasi matjes së disa parametrave të caktuar, parametra të cilët për impiantet gjeneruese të energjisë elektrike nuk janë të matshëm nëse vetë impianti nuk është në funksion, gjë që bie në kundërtënie me procedurat e licensimit nga ZRRE, pasi që pa licencë atij impianti nuk i lejohet të operoj d.m.th. nuk mund të bëhet matja e parametrave ndotës të parashtruar në Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, ku sipas Nenit 1 qëllimi i tij është:



Parandalimi dhe kontrollimi i ndotjes nga aktivitetet industriale, në përputhshmëri me Direktivën 2010/75/BE për emisionet industriale / parandalimin e ndotjes. [14]

Kushtet të cilat operatori duhet të ndjek për t'u pajisur me **Leje Mjedisore** janë të përshkruara në:

"UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR.04/2022 PËR LEJE MJEDISORE"

ku sipas Nenit 5 operuesi duhet të paraqes në Ministri:

Formularin e kërkesës për Leje Mjedisore të nënshkruar nga personi përgjegjës i kompanisë (mirret dhe plotësohet në MMPHI);



Aplikacionin për Leje Mjedisore (shkarkohet nga uebfaqja lejedhelicensa.rks-org.net apo huazohet nga UA);



Çertifikatën e biznesit (mirret në komunën përkatëse);



Vendimin e Pëlqimit Mjedisor të lëshuar nga Ministria;



Dëshmi se janë plotësuar kushtet e përcaktuara në shtojcën 2 të Udhëzimit Administrativ;



Plotësimin e kushteve mjedisore të përcaktuara nga komisioni pas realizimit të vizitës në terren;



Çertifikatën e përdorimit ose një dokument nga Komuna/Ministria, për lejimin e ushtrimit së veprimtarisë;




Në rastet kur kemi të bëjmë me marrje të Lejes Ujore:

- Leja Ujore për shfrytëzim të ujit nga ARPL (sigurohet në ministri);
- Leja Ujore për shkarkim të ujit nga ARPL (sigurohet në ministri);

Në rastet kur kemi të bëjmë me aktivitete të veçanta të cilat parashohin shfrytëzim apo eksploatim të gurëthyesve në Kosovë, nevojitet:

- Leje për aktivitete të veçanta nga KPMM;
- Licencë shfrytëzimi të resurseve natyrore nga KPMM;



Gjithashtu, nevojiten dokumentet shtesë si:

- Pëlqimi nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME);
- Lejet e tjera të lëshuara paraprakisht që ndërlidhen me veprimtarinë përkatëse;
- Faturën e pagesës së tarifës së shërbimit për Leje Mjedisore;



Në rast që investitori ka qenë në gjendje të sigurojë të gjithë dokumentacionin e duhur dhe pas realizimit në terren me sukses, atëherë operatori pajisjet me Leje Mjedisore. Nëse dokumentacioni nuk është i kompletuar, komisioni e njofton operatorin të plotësojë dokumentet e kërkuara në afat prej 30 ditëve, në të kundërtën, Ministria e ndërprejë procedurën.



Dokumentacioni i përgatitur dorëzohet në ministri në 5 kopje fizike dhe një kopje në formë elektronike, të gjitha origjinale të nënshkruara nga personi përgjegjës i kompanisë. Pasi që një aplikant i siguron dokumentet e lartpërmendura, Komisioni për Leje Mjedisore ka për obligim ta vizitojë atë në terren me qëllim të verifikimit të kushteve mjedisore nëse ajo ndërmarrje i plotëson kushtet mjedisore për zhvillimin e veprimtarisë.

Leja Mjedisore lëshohet për periudhën 5 vjeçare dhe përmban të dhëna si:

- Emrin e Ministrisë si autoritet kompetent që lëshon leje mjedisore;
- Emrin dhe adresën e kompanisë të cilës i lëshohet leja mjedisore;
- Lokacionin e veprimtarisë;
- Obligimet e lejes mjedisore;



SFIDAT EKZISTUESE PËRGJATË DHËNIES SË LEJEVE NË KOSOVË

Pothuajse 2 vite është lansuar uebfaqja lejelicensa.arks-gov.net/, platformë kjo e publikuar në faqen zyrtare të Zyrës të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, themeluar në bazë të Ligjit Nr. 04/L-202 "Për sistemin e lejeve dhe licencave". Ky ligj përcakton krijimin, menaxhimin dhe funksionimin e regjistrit të lejeve dhe licencave në nivel qendror në Republikën e Kosovës. Në këtë platformë gjenden të gjitha llojet e lejeve dhe licencave (përfshirë certifikimet, autorizimet, miratimet, pëlqimet etj.) që institucionet e nivelit qendror japin ose lëshojnë në mënyrë që të rregullojnë aktivitetet profesionale ekonomike, tregtare si dhe publike apo private. [15] Fatkeqësisht, kjo platformë nuk është e përditësuar për më shumë se një vit.



REGJISTRI QENDROR I LEJEVE DHE LICENCAVE
Zyra e Kryeministrit
Zyra Ligjore

Ballina | Kërkim i Shpejtë | Filtro Lejet | Statistikat | Ndihma | Komentet

Ligji Nr. 04/L-202 "Për sistemin e lejeve dhe licencave" miratuar nga Kuvendi i Kosovës në Dhjetor 2013, përcakton krijimin, menaxhimin dhe funksionimin e regjistrit të lejeve dhe licencave në nivel qendror në Republikën e Kosovës. Në këtë regjistër mund të gjeni të gjitha llojet e lejeve dhe licencave (përfshirë certifikimet, autorizimet, miratimet, pëlqimet, etj.) Që institucionet e nivelit qendror japin ose lëshojnë në mënyrë që të rregullojnë aktivitetet profesionale ekonomike, tregtare si dhe publike dhe private.

Lejet e reja

- Regjistrimi i Përfaqësuesve të Autorizuar në Fushën e Pronësisë Industriale
- Vendim për Lejimin e Shitjes së Punimeve nga Metalet e Çmuara
- Regjistrimi i Mjeteve Matëse në Regjistër
- Shiko më shumë ...

Lejet e fundit të shikuara


- Licencë për zhvillimin e veprimtarisë së peshkimit ekonomik
- Licencë për qendër të mjekësisë familjare
- Licencë për stomatolog
- Shiko më shumë ...

Institucionet më të shikuara

- Zyre e Rregullatorit të Energjisë
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
- Shiko më shumë ...

Figura 1. Ballina e uebsajtit lejedhelicensa.arks-org.net

[15] Zyra e Kryeministrit, Regjistri qendror i lejeve dhe licensave, e qasshme në: <https://lejelicensa.arks-gov.net/>



Kompetencat për mirëmbajtje të saj i mban Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Pas intervistave të realizuara, kemi konstatuar se ndërrimi i punonjësve të palëve përgjegjëse ka shkaktuar mosfunksionalizimin e duhur të saj. Vështruar nga këndi i një investitori të mundshëm, duke u bazuar në procedurat administrative të shtjelluara (për të cilat edhe vetë zyrtarët e MMPH-së nuk ishin në dijeni), investitori ka tendencë të ndjek një procedurë për aplikim për Leje/Licencë e cila mund të mos jetë e duhura.

Vështruar nga këndvështrimi i një monitoruesi apo hulumtuesi të çfarëdoshëm – të tillët do të pajisen me informata të pasakta, pasi që, të gjitha statistikat e publikuara dhe diagramet e ilustruara datojnë muaj më parë. Vështruar nga vetë punonjësit, të cilët për çdo ditë merren me shqyrtimin e një mori aplikacionesh, punë fatkeqësisht e paraportuar, që mund të ngrit dyshime tek palët e jashtme të cilët me gjithë gjasë mund edhe të ngritin ndonjë ankesë të paqëndrueshme mbi veprimtarinë e tyre.





LIGJI NR. 04/L-202 PËR SISTEMIN E LEJEVE DHE LICENCAVE

thekson qartë në kreun VII që duhet të bëhet përditësimi i të dhënave në Regjistrin Qendror të lejeve dhe licencave. Saktësisht neni 29 i këtij kreu thotë:

“ZYRA LIGJORE E ZYRËS SË KRYEMINISTRIT APO AUTORITETI TJETËR I PËRCAKTUAR NGA QEVERIA MBAN DHE PËRDTËSON REGJISTRIN E LEJEVE DHE LICENCAVE QË LËSHOHEN NGA INSTITUCIONET QENDRORE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS.”

Ndërsa ky regjistër tash e shumë kohë nuk është përditësuar me të dhëna të fundit, të cilat do të shtonin nivelin e transparencës dhe do të ofron llogaridhënie shtesë për publikun. Përpos nenit 29, në kundërshtim bie veprimtaria e institucioneve përkatëse edhe me nenin 32 – Efekti juridik i Regjistrin Qendror të llojeve të lejeve dhe licencave, ku pika 1 dhe 2 e këtij neni theksojnë si më poshtë:

1. Të gjitha llojet e lejeve dhe licencave të cilat nuk figurojnë në Regjistrin Qendror të lejeve dhe licencave nuk kanë efekt juridik;

2. Udhëheqësit e institucione përkatëse që lëshojnë leje dhe licenca janë përgjegjës për dërgimin dhe përditësimin e të dhënave për Regjistrin Qendror të llojeve të lejeve dhe licencave;

Humbja e efektit juridik të një leje apo licence do të thotë tërheqje të investimeve dhe mosbesueshmëri ndaj institucioneve. Vetë fakti që përditësimi i i Regjistrin Qendror i Lejeve dhe Licencave nuk ka të ngjarë, paraqet në vetvete një shqetësim kolektiv. Humbja e efektit juridik nënkupton edhe humbje të vlefshmërisë së dokumentit, andaj, duhet të ndërmerren hapa të menjëhershëm për përditësimin e uebsajtit <https://lejelicenca.rks-gov.net/>, në mënyrë që përpos mbrojtjes së poseduesit të dokumentit, të thjeshtësohet i gjithë zingjiri i këtij procesi kompleks.

Qysh në fillim të aplikimit për Leje Mjedisore, qoftë në nivel komunal apo qendror, operatori gjendet në një udhëkryq të formuar vetvetiu. Në njërën anë kemi një platformë të pa përditësuar, në anën tjetër kemi mungesë të një zyre informuese (One-Stop-Shop) e cila jo vetëm që do t'u lehtësonte punën operatorëve por edhe vetë zyrtarëve pavarësisht nivelit operues të tyre.



Përderisa procesi për pajisje me leje kalon nëpër një mori faza, nëpër një mori shqyrtimesh të një aplikacioni bazuar në një mori aktesh ligjore, mungesa e një destinacioni ndërmjetësues padyshim që lë hapësirë për keqpërdorime nga palët e treta të përfshira. “4 kopje fizike origjinale të vulosura” dhe jo vetëm të një dokumenti – për një vend i cili është duke u ndërtuar çdo ditë e më shumë, mbledhja e një mori dokumentesh të cilat lehtë mund të digjitalizohen, shpion në vonesë të procedurës për marrje të lejes. Pasi që këto dokumente nga aplikuesi duhet të sigurohen në komunat e tyre përkatëse dhe më tutje të përcillen në nivelin qendror mbrenda një kohë të caktuar, përsheptimi i procesit mund të shpie në keqpërdorim të pozitës zyrtare, rrjedhimisht, në mungesë të llogaridhënies.

Për më tepër, këto dokumente duhet të jenë të vulosura dhe të nënshkruara nga vetë aplikuesi/hartuesi. Hamendësojmë një investitor të huaj i cili shpreh interes të investojë në Kosovë. Në këtë rast, është më se e kuptueshme që nevoja për një ndërmjetësues/konsulet është më se e domosdoshme. Përpos vonesave, vështirësive që mund të haset në sigurim të dokumenteve, duhet ballafaquar me institucione të cilat nuk njohin një aplikacion, nënshkrim apo vulë të digjitalizuar, ani pse kanë për synim promovimin dhe themelimin e një sektori të qëndrueshme pa printime të paarsyeshme. Aplikacioni i dorëzuar në ministri, protokohet. Pas kësaj, aplikanti nuk ka më asnjë informatë shtesë se çfarë ka ndodhur me lëndën e tij, se në cilën fazë ka kaluar apo edhe nëse është shqyrtuar. Në rastin më të keq, për shkak të ngarkesës të madhe të punës apo formimit të vonshëm të komisionit, dokumentacioni përfundon duke lundruar nga një departament tek tjetri pa u shqyrtuar fare, ani pse afati për shqyrtim gradualisht i vie fundi. Në mungesë të një sistemi gjurmues, gjasat për ndërhyrje tek zyrtarët e nivelit qendror janë tepër të larta, gjë që ndikon në ulje të transparencës duke çuar në performancë të dobët institucionale.

Sipas Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, afati kohor për të cilin duhet të shqyrtohet lënda e protokoluar mund të shkojë deri në 90 ditë pune. Ky afat i caktuar me shumë gjasa tejkalon afatin prej 3 muajve, si shkak e formimit të mëvonshëm të komisionit – marrë parasysh që shumica e zyrtarëve veçmë se janë të stërngarkuar me përmbushjen e obligimeve të tjera. Rrjedhimisht, formimi i mëvonshëm i komisionit shpie në shqyrtim të mëvonshëm të aplikacioneve për marrje të lejes. Kjo dukuri, sigurisht që mund të lë hapësirë për keqpërdorime pasi që përshpejtimi i procedurave të shtjellimit të dokumentacioneve mund të realizohet vetëm në rast që investitori kërkon takimë më zyrtarët përgjegjës. Në të kundërtën, vonesat në marrje të lejes pengojnë funksionalizimin e impianteve tashmë të realizuara pasi që i tilli nuk mund të funksionojë në mungesë të pranimit teknik. Në rastet kur kemi të bëjmë me funksionalizimin e impianteve, gjeneratorë të energjisë elektrike, mosfunksionalizimi i tyre shpie në humbje të investimit të mundshëm nga ana e investorëve, gjë që mund të ndikoj edhe në tërheqje të këtyre investimeve në vendin tonë.



Nëse dokumentacioni nuk është i kompletuar, komisioni e njofton operatorin të plotësoj dokumentet e kërkuara në afat prej tridhjetë (30) ditë nga data e pranimit të kërkesës. Paralelisht, drejtorive përgjegjëse në nivel komunal u lejohe të procesojnë kërkesën më tutje në afat prej 30 ditëve. Në rast që aplikuesi menjëherë pas marrjes së përgjigjes nga komisioni në nivel qendror e përcjell në drejtorinë përkatëse në nivel komunal, ekziston risku që për shkak të kësaj mos përputhje kohore, aplikacioni i tij të refuzohet. Nëse brenda afatit të përcaktuar, nuk plotësohet dokumentacioni, Ministria e ndërpre procedurën. Në raste të tilla, barra për koordinim të institucioneve në të dy nivelet, bie tek operatori, i cili mund të ngec pa pajisje me Leje Mjedisore.

***“NË EMËR TË
TRANSPARENCËS,
PO HUMB TRANSPARENCA”***



Me datë 24 tetor 2022, Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përmes një postimi në rrjetet sociale, njoftoi publikun e gjerë mbi Aktet Administrative të lëshuara për gjatë vitit 2022 nga MMPHI. Në këtë dokument, janë të paraqitura gjithsej 101 vendime ujore të lëshuara gjatë vitit 2022. Në të njejtën kohë, këto vendime nuk janë të publikuara në faqen e MMPHI, ani pse në postimin e Ministrit Aliu thuhet se të gjitha këto vendime gjenden në faqen zyrtare të Ministrisë.

Duke synuar llogaridhënien dhe rritjen e transparencës, do të ishte e udhës që së pari dokumenti në fjalë, i publikuar në tetor të vitit të kaluar, të jetë në formatin PDF, i qasshëm direkt në faqen e MMPHI-së. Ky dokument do të duhej të përditësohej në baza mujore, në mënyrë që qytetarët, akterët relevant, shoqëria civile dhe kushdo tjetër i interesuar në këto vendime, të ketë një qasje më të lehtë dhe më të shpejt. Përpos mospublikimit të vendimeve në faqen e Ministrisë, publikimi i vendimeve një e nga një do të shkaktonte ngarkim, konfuzitet dhe vështirësi në monitorim të punës së Ministrisë dhe palëve të treta.

Andaj, në të mirën e një qeverisje të qëndrueshme, transparente dhe llogaridhënëse, raportet e MMPHI-së duhet të integrohen në vegza e uebsajtit <https://lejlicenca.arks-gov.net/>, ku këtu mund të bëhet publikimi i të gjitha vendimeve të aprovuara, mirëpo edhe atyre të refuzuara nga ana e MMPHI. Ky uebsajt, gjithashtu duhet të përfshij edhe informatat e mëposhtme:

- PROCEDURA PËR PAJISJE ME LEJE, LICENCË APO PËLQIM;
- KOHËZGJATJA DHE TARIFAT;
- INFORMATAT KONTAKTUESE TË PERSONIT PËRGJEGJËS NË KUADËR TË MINISTRISË;

Ndërlidhja e uebsajtit të MMPHI -së me uebsajtin <https://lejlicenca.arks-gov.net/>, është kontribut ndaj transparencës, lehtësim të monitorimit dhe efikasitet e funksionalizim të mirëfilltë të uebsajteve tashmë ekzistuese.

GJENDJA AKTUALE

INDIKATORËT

SFIDAT

REKOMANDIMET

Transparenca

Përditësimi i lejeve dhe licencave

Institucionet përkatëse, të cilat janë përgjegjëse në procesin e e Lejeve, Licencave dhe Pëlqimeve, të përditësojnë dhe raportojnë në baza ditore listën e këtyre dokumenteve.

Qasja në të dhëna

Të zbatohet Ligji Nr. 06/ L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në mënyrë që të gjithë të interesuarit të kenë informata mbi aplikimet për Leje, Licenca dhe Pëlqime. Qasja e barabartë nënkupton transparencë të shtuar dhe evitim të keqpërdorimeve të mundshme, favorizimeve dhe ryshfeteve.

Llogaridhënia

Vonesa në shqyrtim të aplikimeve për leje

Të themelohet njësi monitoruese në kuadër të Ministrisë dhe në kuadër të Drejtorive komunale, e cila monitoron mbarëvajtjen e procedurave për aplikim.

Përgjegjësia ndaj humbjes/ngatrrimit së mundshëm të dokumentacionit për aplikim për Leje, Licenca dhe Pëlqime

Të themelohet E-Arkiva, e cila mundëson digjitalizimin e procedurës dhe shërben për ruajtjen e dokumentacionit për aplikim.

Përditësimi i uebsajtit lejelicenca.rks-gov.net/

Në baza ditore, javore dhe mujore, të përditësohen të dhënat, dhe të publikohen të gjitha Lejet, Licencat dhe Pëlqimet në uebsajt.

Integrimi i uebsajtit lejelicenca.rks-gov.net/ në uebsajtet e Ministrive përkatëse

Të integrohet uebsajti lejelicenca.rks-gov.net/ në uebsajtet e Ministrive përkatëse, në mënyrë që të thjeshtësohet sa më shumë procedura e informimit, të rritet transparenca dhe të ketë ndërlidhje mes uebsajteve të Ministrisë me ato të Kryeministrisë.

Digjitalizimi

Digjitalizimi i procedurës së aplikimit për Leje, Licenca dhe Pëlqime

Në mënyrë që të rritet efikasiteti, transparenca dhe llogaridhënia, kursimi i kohës dhe ulja e kostove, menaxhimi dhe analizimi i të dhënave, duhet që të digjitalizohet i gjithë procesi i procedurës së aplikimit për Leje, Licenca dhe Pëlqime, në nivel qendror dhe në atë lokal.

Digjitalizimi i procedurës së ankesave

Në mënyrë që të përshpejtohet procesi, të ngritet niveli i transparencës dhe llogaridhënies, të bëhet kursimi i kohës dhe ulja e kostove, duhet që të digjitalizohet i gjithë procesi i ankesave për aplikimet për Leje, Licenca dhe Pëlqime, në nivel qendror dhe në atë lokal.

GJENDJA AKTUALE

INDIKATORËT	SFIDAT	REKOMANDIMET
Procedurat	Informimi i cekët për procedurat e aplikimit	Të formohet një One-Stop-Shop në nivel qendror, i cili ka kompetenca informuese mbi procedurën e aplikimit për Leje, Licenca dhe Pëlqime.
	Kordinimi i nivelit qendror dhe nivelit lokal për aplikimet e Lejeve, Licencave dhe Pëlqimeve	Të rritet koordinimi ndërmjet niveleve qendrore dhe lokale të qeverisjes për aplikimet për Leje, Licenca dhe Pëlqime në Kosovë. Ky koordinim është thelbësor për administrimin efikas dhe efektiv të këtyre proceseve. Koordinimi i shtuar nënkupton procese të thjeshtuara dhe në linjë me njëra tjetrën, konsistencë dhe barazi, menaxhim efektiv të burimeve, si dhe bashkëpunim të shtuar të akterëve relevant.
	Mospërputhshmëria e dokumentave strategjike urbanistike ndërmjet nivelit qendror dhe nivelit lokal	Mospërputhshmëria shpesh pengon planifikimin, zhvillimin dhe qeverisjen urbane efektive. Hartimi i udhëzimeve dhe standardeve të tjera, forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit, inkurajimi i pjesëmarrjes dhe angazhimit, si dhe rishikimi dhe përditësimi i legjislacionit dhe rregulloreve aktuale, do të ofrojë harmoni të shtuar mes nivelit qendror dhe atit lokal si në aspektet kohore, ashtu edhe në aspekt të efijencës së përgjithshme. Andaj duhet që të harmonizohen të gjitha dokumentet në dy nivelet e qeverisjes.
	Mospërputhshmëria e afatave kohore mes nivelit qendror dhe nivelit lokal	Të koordinohen afatet kohore mes nivelit qendror dhe nivelit lokal, në mënyrë që të përputhen me kohën e plotësimit të dokumentacionit, të rritjes së efikasitetit të procesit, dhe kursimit të kohës.
	Përditësimi i dokumentacionit për aplikim për Leje, Licenca dhe Pëlqime	Në mënyrë që të ngritet niveli i saktësisës së informacionit, institucionet përkatëse të bëjnë përditësimin e dokumentacionit të nevojshëm në uebsajtet e tyre.
Komisioni	Mungesa e burimeve njerëzore për shqyrtim të aplikimeve	Procedura e shqyrtimit të aplikimeve për Leje, Licenca dhe Pëlqime, shpeshherë hasë në zgjatje të afatave kohore si shkak i mungesës së burimeve njerëzore. Andaj, të shtohen kapacitetet humane për këtë proces, e gjithashtu të përfshihet një/dy anëtar të shoqërisë civile në mënyrë që të rritet transparenca dhe llogaridhënia.
	Caktimi i datës së mbledhjes së komisionit për shqyrtimin e aplikacioneve	Të definohet saktë data e mbledhjes së komisionit, në mënyrë që aplikuesit të jenë të informuar mbi datën e shqyrtimit të aplikimit të tyre.
Tarifat	Taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje pavarësisht vitit të ndërtimit	Të rishqyrtohen tarifat për legalizim të ndërtimeve pa leje, në mënyrë që kjo tarifë të jetë më pak e favroshme se sa tarifa fillestare për pajisjen me Leje Ndërtimore.

PËRFUNDIME

Kosova ka probleme serioze me menaxhimin urban, konkretisht me lëshimin e lejeve mjedisore dhe me planifikim të mirëfilltë hapësinor. Rrjedhimisht, kërkesa në rritje për strehim, infrastrukturë dhe energji, vazhdon të rrezikoj resurset natyrore duke dërguar në mungesë të hapësirave të gjelbra, shkatërrim të habitateve natyrore dhe menaxhim joadekuat të mbeturinave. Për të bërë gjërat më keq, dukuria e zaptimit të tokës pjellore nga aktivitetet ilegale urbane dhe industriale si dhe mungesa e llogaridhënies së personave përgjegjës po shpion në modele të paqëndrueshme të shfrytëzimit të këtyre resurseve.

Procedura komplekse, rregullore të paharmonizuara, kapacitete institucionale dhe burime financiare të limituara, mungesa e të dhënave relevante dhe jo digjitalizimi i atyre ekzistuese, vazhdojnë të cenojnë qëndrueshmërinë e këtij sektori. Hartimi i dokumenteve strategjike, rregulloreve dhe udhëzimeve strategjike me qëllim të menaxhimit adekuat të sipërfaqes tokësore përgjatë formulimit dhe zbatimit të planeve urbane, si dhe planeve zhvillimore komunale nuk po rezultojnë të jenë aq frytdhënëse. Edhe pse, qasja burokratike e institucioneve bën që ato të funksionojnë pa probleme dhe me efikasitet, në rastin e pajisjes me Leje Mjedisore nga Republika e Kosovës, kjo çasje vetëm sa po ndikon në ngadalësimin e tërë procesit licencues. Përmeshja e një seri kriteresh përgjatë plotësimit të formularëve nga institucionet e përfshira, vetëm sa po ndikon në pezullimin e aplikacioneve të cilat për arsye të mos përmeshjes së një apo dy kriterëve, po shpion në bllokimin e aplikacioneve pasardhëse. Këto vonesa vetëm sa po pengojnë investitorët e jashtëm duke shpër në dorëheqje.

Adresimi i sfidave të lartpërmendura, kërkon një qasje të integruar, një qasje, e cila duhet të ketë prioritet zhvillimin e qëndrueshëm urban, menaxhimin efektiv të mjedisit, ruajtjen e burimeve natyrore, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies duke siguruar një të ardhme më të gjelbër, më të qëndrueshme për të gjithë banorët e Republikës së Kosovës. Lejet mjedisore kontribuojnë drejt një sektori urbanistik të qëndrueshëm. Nën barrën e mungesës së një sistemi digjitalizues, stafit të kufizuar dhe mungesës të ekspertëve, përballjen e vazhdueshme me kritika për burimet e saj të cënueshme, joefikasitetin burokratik dhe zbatimin e pamjaftueshëm të rregulloreve mjedisore, si dhe shqetësimet në lidhje me kapacitetin e saj për të trajtuar në mënyrë efektive çështjet urgjente mjedisore si ndotja e ajrit dhe ujit, menaxhimi i mbetjeve dhe ruajtja e burimeve natyrore, lënë pak vend për të imagjinuar një të ardhme ku infrastruktura nuk do të jetë më temë diskutimi.

REKOMANDIME

- 1** Të zhvillohet platforma E-Arkiva në kuadër të digjitalizimit të sistemit për aplikim. Kjo platformë do të thjeshtësonte procedurat për shqyrtim të aplikacioneve duke bërë njëkohësisht ruajtjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave dhe dokumentacioneve. Marrë parasysh që mungesa e digjitalizimit të vetë aplikacionit lë hapësirë për ngatërrim, humbje apo keqpërdorim të vetë dokumentacionit të dorëzuar, ruajtja e tyre në formë elektronike në një platformë të posaçme do të shpie në rritje të transparencës, llogaridhënies si dhe produktivitetit brenda vetë institucionit.
- 2** Të themelohet një One-Stop-Shop – Zyre Informuese. Themelimi i saj siguron qasje të barabartë të gjithë aplikantëve duke i udhëhequr ata njëkohësisht në hapat e duhur të procesit të aplikimit. Duke ofruar një pikë të vetme informuese, investitorët mund të njoftohen paraprakisht mbi afatet kohore, dokumentacionin e duhur si dhe mbarëvajtjen e procesit për aplikim për leje në përgjithësi. Zyrja informuese do sigurojë drejtësi dhe mundësi të barabarta për të gjithë duke reduktuar barrën administrative mbi zyrtarët, duke përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e përgjithshëm të punës së zyrtarëve në nivel qendror.
- 3** Të përditësohet uebsajti lejdhelicensarks-org.net si dhe të integrohet vegëza në faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Edhe pse, faqja e publikuar në faqën zyrtare të Kryeministrit të Kosovës përmban të gjitha procedurat si dhe dokumentacionin me qëllim të marrjes së Lejeve dhe Pëlqimeve nga institucionet përkatëse, ajo nuk është e përditësuar pothuajse që nga krijimi i saj. Ripërditësimi i saj, integrimi i vegzës për ankesa si dhe rifreskimi i grafikëve dhe statistikave të publikuara do të ju shërbente të gjithë hulumtuesve, investitorëve, konsulentëve si dhe zyrtarëve përgjegjës për rishqyrtim të aplikacioneve. Praktika e mirë e aplikuar nga vetë Ministri Aliu, duhet të vazhdohet në mënyrë që të ngritet niveli i transparencës dhe llogaridhënies, e në të njëjtën kohë të lehtësohet monitorimi i keqpërdorimeve të mundshme. Gjithashtu, përditësimi i të dhënave dhe publikimi i tyre do të duhet të jetë edhe pjesë e uebsajtit të MMPHI dhe uebsajtit për Leje e Licenca në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
- 4** Rregullimi, thjeshtësimi si dhe integrimi i uebsajtit zyrtar të faqës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor me uebsajtin zyrtar të Ministrisë së Infrastrukturës. Marrë parasysh që kemi të bëjmë me një institucion të vetëm, duhet të bëhet integrimi i të dy faqeve në një të vetme. Rrjedhimisht, me thjeshtësimin e uebsajtit si dhe riorganizimin e tij, do të lehtësohet monitorimi i institucionit duke ndikuar kështu në rritje të transparencës. Dy uebsajte shkaktojnë konfuzitet, vështirësi në monitorim dhe krijojnë hapësira për keqpërdorime të mundshme, andaj duhet që sa më parë të mbetet vetëm një uebsajt zyrtar i MMPHI.

5

Në nivel komunal, të bëhet implementimi i platformës elektronike eLeja. Integrimi i kësaj platforme në faqet zyrtare në nivel komunal, do të lehtësonte barrën administrative të vetë zyrtarëve të cilët merren me shqyrtim të dokumentacioneve, duke lënë hapësirë për keqpërdorime apo gabime të shkaktuara pa dashje nga vetë zyrtarët. Integrimi i uebsajtit eLeja në faqën zyrtare lejdhelicensa.rks-gov.net apo në ndonjë platformë elektronike të lidhur me faqën zyrtare të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përpos që do të shkurtojte kohën e shqyrtimit të dokumentacioneve, do të ndikonte drejtpërdrejtë edhe në rritje të llogaridhënies nga palët e përfshira.

6

Të vendoset data e saktë gjatë së cilës mblidhet komisioni. Përcaktimi i saktë i kësaj date paraqet një indikator thelbësor informues për të gjithë aplikantët për marrje të lejes dhe licencës. Kjo do sigurojë që aplikuesit të mbahen të mirëinformuar mbi kohën se kur do të shqyrtohen dhe vlerësohen dokumentacionet e tyre pa patur nevojë të ndërmerren kontakte të jashtme.

7

Të mbahen takime të rregullta ndërmjet zyrtarëve të nivelit qendror, përgjegjës për dhënie të lejeve dhe licencave me përfaqësues nga departamenti për mbrojtje të mjedisit si dhe të urbanizimit në nivel komunal. Mungesa e koordinimit ndërmjet tyre si dhe mungesa e informimit padashje shpie në vonesa të shqyrtimit të aplikacioneve si dhe mungesë të informimit mbi përditësimin e dokumenteve nënligjore, ku si pasojë zyrtarët nga niveli komunal pa dashje mund të udhëzojnë investitorët të ndjekin hapa që jo domesdosmërisht janë më të duhurit.

8

Të rishikohet korniza legjislative me qëllim të harmonizimit të akteve nënligjore në të dy nivelet e qeverisjes. Procedura e shqyrtimit të aplikimeve për Leje, Licenca dhe Pëlqime, shpeshherë hasë në zgjatje të afatave kohore si shkak i mungesës së burimeve njerëzore. Andaj, të shtohen kapacitetet humane për këtë proces, e gjithashtu të përfshihet një/dy anëtar të shoqërisë civile në mënyrë që të rritet transparenca dhe llogaridhënia.

Projekt i mbështetur nga:

Projekt i implementuar nga:



Projekti “CorrWatch” financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar përmes Ambasadës Britanike në Prishtinë. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Institutit INDEP, GLPS dhe Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmerisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Komonuelthit dhe Zhvillimit të Mbretërisë së Bashkuar.